



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 14, datë 12.07.2019

**PËR**  
**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:**  
**“NDËRTIMI I BURIMIT TË RI GJENERUES TË ENERGJISË, HEC DRITA, LUMI I**  
**GASHIT, BASHKIA TROPOJË, QARKU KUKËS”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit “Breçani – R.O.S.P” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i burimit të ri gjenerues të energjisë, Hec DRITA, Lumi i Gashit, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Breçani – R.O.S.P” sh.p.k
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tropojë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOFA

